



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 23.12.2017

Komunikatë

PZAP-i sot me datë 23.12.2017, ka shqyrtuar dhe vendosur ankesën e parashtruar dje me datën 22.12.2017 në PZAP nga Subjekti Politik - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), pas shpalljes së Rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve nga ana e KQZ-se lidhur me rivotimin për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura me datë: 17.12.2017. Ankesa është shqyrtuar dhe vendosur brenda afatit ligjor prej 72 orëve, afat ky i cili ka filluar dje me datën 22.12.2017 nga ora 13:35 e i cili përfundon ditën e hënë me datën 25.12.2017 në ora 13:35.

Ndaj vendimit të PZAP-it mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda 24 orëve prej momentit të pranimi të vendimit të PZAP-it nga pala. Ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës duhet të vendosë lidhur me ankesën brenda 72 orëve prej momentit të dorëzimit të ankesës në Gjykatën Supreme. Vendimin lidhur me ankesën e gjeni të publikuara në ueb faqen e PZAP-it me nr. ZL. Anr. 1142/2017.